



KUVENDI

NR. 648 DATE 25.02.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

GRUPI PARLAMENTAR I PARTSË SOCIALISTE

Nr. ____ Prot .

Tiranë, më ____ .2021

Lënda : Depozitim projektligji

Drejtuar:

**Z. GRAMOZ RUÇI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

I nderuar Z.Kryetar,

Bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes projektligjin “DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8577, DATË 10.02.2000, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJKATËS KUSHTETUESE”, TË NDRYSHUAR”.

DEPUTETI PROPOZUES

Albilda Busha

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____ / 2021

“PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8577, DATË
10.02.2000, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS
KUSHTETUESE”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e disa deputetëve, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7/b, paragrafi i tretë, fjalia “Nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit.” shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 7/c, paragrafi i katërt, fjalia “Nëse ka më shumë se një vend vakant Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit.” shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 18, pika e 3, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia e dytë si më poshtë:

“Në rastet kur, përpara emërimit, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzonte statusin e magjistratit, në përfundim të mandatit si gjyqtar i gjykatës Kushtetuese, ka të drejtë të caktohet të paktën në një pozicion në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ose në prokurori, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.”

Neni 4

Në nenin 86, pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje si më poshtë:

“Deri në emërimin e të paktën tre të katërtat e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, por, në çdo rast, jo më vonë se data 31.12.2023, mbledhja e posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, sipas pikës 3, të nenit 7/ç, të këtij ligji, është e vlefshme nëse marrin pjesë të paktën gjysma e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI